

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Islanda i thotë “jo” BE-së, shumica e banorëve refuzuan në referendum bisedimet për anëtarsimin në Union – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/islanda-i-thote-jo-be-se-shumica-e-banoreve-refuzuan-ne-refere-ndum-bisedimet-per-anetarsimin-ne-union/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:12:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	30 gusht 2026, 12:32:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c1d17e91bea789fd0537f7e7425247209c6024646fedfc5ba03cc6adfac3ca14
TEKSTI	4132b84e8c0bf0a90fc15c6d4b927ad19f77649854a4c0f7e10b950a435cad44
PAMJA	8af77036ea4986c04f8f61a2af690d81dd5d029f09a718157819692f9de7c2e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6fd12418a72a88ecb57597704bbd54c9406e3d64549ead2de73cb5e813b46665
E MËPARSHMJA	208187832ab0c92de638098a6ea37018717d5e7e5edf93d6dffffef42796ad34b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6fd12418a72a88ecb57597704bbd54c9406e3d64549ead2de73cb5e813b46665>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Në referendumin e zhvilluar të shtunën, shumica e islandezëve votuan kundër rikthimit në tryezën e bisedimeve me Brukselin. Sipas rezultateve të raportuara nga mediat, rreth 52.5 për qind votuan kundër, ndërsa 47.5 për qind pro. Votat e mbetura në një zonë zgjedhore nuk pritet të ndryshojnë rezultatin.

Votimi ishte një goditje për qeverinë e kryeministres Krístrún Frostadóttir, e cila e kishte paraqitur rikthimin e negociatave si një moment vendimtar për të ardhmen e vendit. Qeveria argumentonte se lidhjet më të forta me Bashkimin European do t'i jepnin Islandës më shumë siguri ekonomike dhe politike, në një periudhë të karakterizuar nga pasiguria ndërkombëtare, lufta në Ukrainë dhe tensionet në Arktik.

Një tjetër faktor që ndikoi në debatin publik ishte qëndrimi i presidentit amerikan Donald Trump ndaj Groenlandës. Kërcënimet e përsëritura të Trumpit për marrjen nën kontroll të territorit autonom danez shtuan shqetësimet për sigurinë dhe të ardhmen gjeopolitike të vendeve të Arktikut. Përkrahësit e rifillimit të negociatave argumentuan se një afrim me BE-në do t'i jepte Islandës një pozicion më të fortë në një botë gjithnjë e më të pasigurt.

Por kundërshtarët e integritetit european e vendosën në qendër të fushatës sovranitetin kombëtar dhe, mbi të gjitha, kontrollin e ujërave të peshkimit. Peshkimi mbetet një sektor kyç për ekonominë islandeze dhe një nga çështjet më të ndjeshme në marrëdhëniet e vendit me Bashkimin European. Kundërshtarët argumentuan se anëtarësimi mund të kufizonte kontrollin e Islandës mbi burimet e saj detare.

5 Elbasani nuk tan Egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emëlli juaj

Abonohu

Debati për anëtarësimin nuk është i ri. Islanda aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Europian në vitin 2009, në kulmin e krizës financiare, dhe negocioi me Brukselin për disa vite. Por një qeveri euroskeptike i ndërpreu negociatat në vitin 2013.

Referendumi i kësaj fundjave ishte vetëm hapi i parë që mund ta rikthente procesin. Një votë pro do të kishte hapur negociata të reja me Brukselin dhe, nëse do të arrihej një marrëveshje, islandezët do të duhej të votonin sërish në një referendum të dytë për anëtarësimin përfundimtar në BE.

Tani, me fitoren e kampit kundërshtues, qeveria islandeze përballet me një pengesë të rëndësishme në përpjekjen për ta afruar vendin me Bashkimin Europian. Për Brukselin, rezultati është gjithashtu një sinjal i vështirësive që mund të shoqërojnë procesin e zgjerimit, edhe në një kohë kur BE-ja kërkon të forcojë lidhjet me vendet europiane përballë pasigurive të reja gjeopolitike.

Për Islandën, megjithatë, çështja e marrëdhënies me Europën mbetet e hapur për debat. Vendi është tashmë pjesë e tregut të përbashkët europian dhe zonës Shengen, por nuk ka një rol formal në institucionet vendimmarrëse të BE-së.

#BE

#Islanda

#NataChampions




Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë video



VIDEO

Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...

Xhuljana Zhuleku 56 minuta më parë



VIDEO

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku 2 orë më parë



VIDEO

Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:17



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.